Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP³.

_____ etj.

SQARIM: Për efekt verifikimi nga AK -ja, për personin/at, e sipërcituar duhet të pasqyrohen gjithashtu të dhënat si vijojne: numri i kartes se identitetit, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

³ Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

Shtojca 7/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË
MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

I. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- d) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- e) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

***Sqarim:** Mbështetur në nenin 74/3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*

- b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1
- c. Sigurimi i ofertes (*nuk kerkohet*);
- d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- e. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;
- f. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;
- g. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, OE duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- a) Dokumentacionin e kërkuar në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim.

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare të tre viteve të fundit me vlere jo më pak se 40 % fondi limit të marrëveshjes kuadër.

2.3 Për kapacitetin teknik:

- a) Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, me vlere jo më pak se 40 % e fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Në rastin kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ent publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim(e) realizimi, lëshuar nga enti publik, si dhe faturë(a) tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve dhe mallrave të realizuara.

Ose

Në rastin kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturë(a) tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve dhe mallrave të realizuara.

- b) Operatori ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO si më poshte:
 - i. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.
 - ii. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme të jenë lëshuar nga një organ i akredituar. Kur operatori ekonomik hyn si bashkim operatorësh ekonomikë, sicili operator pjesëmarrës duhet t'i plotësojë ISO sipas zërave që ka marrë përsipër të realizojë në marrëveshjen e bashkëpunimit.

- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencë për ushtrimin e aktivitetit që mbulon të gjithë tipologjinë e mbetjeve, me Kod III.2.B për objektin e veprimtarisë, të lëshuar nga QKL.
- d) Operatori Ekonomik Operatori Ekonomik do të deklarojë se nëse do të jetë fitues përpara firmosjes së kontratës, merre përsipër të paraqesë kontratat e duhura të lidhura për

trajtimin/asgjesimin fundor të mbetjeve në facilitetet adekuate, impjantet e trajtimit ose landfillet sipas kuadrit të legjislacionit shqiptar për lisën e mbetjeve sipas Shtojcës II. Kontrata duhet të përfshijë të gjithë periudhën e kontratës së lidhur ndërmjet AGSco dhe Kontraktorit.

e) *Operatori ekonomik duhet të të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për ekzekutimin me sukses të kontratës sipas tabelës më poshtë:*

Nr.	Mjetet	Numri min. i mjeteve	Kapaciteti minimal	Dokumentet që duhet të paraqesë operatori ekonomik për secilen nga mjetet dhe pajisjet
1	Mjete teknologjike (Kamion) për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve urbane	2	Min 18 T	<ul style="list-style-type: none"> • Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing • Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar
2	Autobot për transportin e mbetjeve vajore i pajisur me bllokues të shkëndijave	1	Min 5000 lt	<ul style="list-style-type: none"> • Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing • Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar • Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin të shkëndijave për mjetin (spark arrestor).
3	Autobot për transportin e ujrave të zeza i pajisur me bllokues të shkëndijave	1	Min 2500 lt	<ul style="list-style-type: none"> • Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing • Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar • Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin e shkëndijave për mjetin (spark arrestor)
4	Kamionë ose kamioncina transporti me kontenier për transportin e mbetjeve të riciklueshme	1	Min 10 m ³	<ul style="list-style-type: none"> • Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing • Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar • Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin e shkëndijave për mjetin (spark arrestor)
5	Kamionë ose kamioncina transporti me kontenier për transportin e mbetjeve të rrezikshme	1	Min 300 KW (kuaj fuqi)	<ul style="list-style-type: none"> • Leja e qarkullimit ose kontrata e leasing • Leja e drejtimit e të paktën një shoferi të autorizuar • Vetë deklarata e pajisjes me bllokuesin e shkëndijave për mjetin (spark arrestor)
6	Kontenier	5	Min 3 m ³	Fatura e blerjes ose kontrata e qerasë
7	Kosha	30	Min 1 m ³	Fatura e blerjes ose kontrata e qerasë

8	Rakorderi presioni me lidhje të shpejtë 2''	1	Sipas ISO 14420-7	Fatura e blerjes ose kontrata e qerasë Vetë deklarata e përputhshmërisë me ISO-n
---	---	---	-------------------	--

Për plotësimin e këtij kriteri duhet që:

- i. *Operatori ekonomik të paraqesë dokumentet provuese të disponimit të mjeteve dhe pajisjeve teknike në dispozicion të përcaktuara në tabelën e mësipërme, pwrkatesisht “**Dokumentet që duhet te paraqesë operatori ekonomik per secilen nga mjetet dhe pajisjet**”.*
- f) *Operatori Ekonomik duhet të diponjë në stafin minimumi 6 (gjashtë) persona si më poshtë:*
- 1 (një) Koordinator për aktivitetet e shërbimit.
 - 1 (një) Inxhinier të caktuar si Person Përgjegjës për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë ose të paraqesë kontratën ekzistuese me një palë të tretë për plotësimin e këtij roli sipas Ligjit 10237/2010.
 - 2 (dy) Shoferë të pajisur me lejet e drejtimit për kategoritë e mjeteve të përmendura më sipër për mbetjet jo të rrezikshme. Të paktën njëri nga shoferat e mësipërm duhet të jetë i pajisur me kategorinë e lejes së drejtimit dhe licencat përkatëse për drejtimin e mjeteve që transportojnë mbetje të rrezikshme sipas “Marrëveshja Evropiane në lidhje me Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshëm” (p.sh Licenca ADR) në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
 - 2 (dy) punonjës për të kryer aktivitetet.

I gjithë personeli duhet të jetë i përshtatshëm për të performuar aktivitetet duke respektuar Ligjin 10237/2010 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe rregullave të tjera për sigurnë në punë.

Për të plotësuar këtë kriter, operatori ekonomik do të paraqesë:

- i. *Për të vërtetuar numrin minimal prej 6 (gjashtë) personash, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listë pagesat e tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.*
 - ii. *Per Inxhinierin e caktuar si Person Përgjegjës për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë, lejohet që ai të jetë i kontraktuar për periudhën e realizimit të kontratës qe po prokurojme, dhe OE duhet te dorezoje kete kontrate.*
 - iii. *Per punonjesit e tjere, Operatori ekonomik duhet te dorezoje evidenca si (regjistra dhe/ose procesverbale dhe/ose raporte dhe/ose certifikata) për trajnimin e punonjësve.*
- g) *Operatori Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara ne Kodin e Etikes te AGS SHA qe kane lidhje me realizimin e objektit te kesaj kontrate. (ky kod eshte i publikuar në SPE se bashku me DT);*

Shënim: Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 11

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Sherbimet per menaxhimin e mbetjeve qe do te realizohen jane si me poshte:

Kodi	A. Lista e kategorise se mbetjeve	Sasia indikuese	Njesia
05 01 03*	Llumra të fundit të depozitave	2000	kg
08 01 11*	Mbetje të bojërave dhe llaqeve që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme	20	kg
08 01 12	Mbetje të bojërave dhe llaqeve, të tjera nga ato të përmendura në 08 01 11 *	20	kg
08 03 17*	Mbetje nga bojë printi që përmbajnë substancë të rrezikshme	100	Kg
08 04 09*	Mbetje të ngjitësve dhe stukove që përmbajnë tretës organikë ose substanca të tjera të rrezikshme	20	kg
12 01 09*	Solucione dhe emulsione të makinerive që nuk përmbajnë halogjenë	100	Kg
12 01 12*	Parafinat dhe yndyrat e shpenzuara	20	kg
12 03 01*	Lëngje larës ujore	2000	kg
13 01 10*	Vaj hidraulik i paklorinuar me bazë minerale	200	kg
13 02 05*	Vajra motori, ingranazhesh dhe lubrifikues të pa klorinuar me bazë minerale	1000	Lt
13 02 06*	Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues	400	kg
13 05 07*	Ujë me naftë nga seperatorët ujë/naftë	4000	Lt
15 01 01	Mbetje ambalazhi letre dhe kartoni	1400	kg
15 01 02	Mbetje ambalazhi plastike	1200	kg
15 01 03	Mbetje ambalazhi druri	600	kg
15 01 04	Mbetje ambalazhi metalike	200	kg
15 01 07	Mbetje ambalazhi qelqi	100	kg
15 01 10*	Mbetje ambalazhi që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	600	kg
15 01 11*	Mbetje ambalazhi metalike që përmbajnë materiale poroze (p.sh. azbest), duke përfshirë kontenieret bosh të presioneve	400	kg
15 02 02*	Absorbues, materiale filtri (përfshirë filtrat e vajit që nuk specifikohen ndryshe), leckat e pastrimit, veshje mbrojtëse të ndotura nga substanca të rrezikshme	1400	kg
15 02 03	Absorbente, materiale filtrues, copa rroba thithëse, të tjera nga ato të përmendura në 15 02 02 *	400	kg
16 01 07*	Filtra vaji, naftë	800	kg
16 02 13*	Pajisje skarco që kanë përbërës të rrezikshëm 16 02 09 deri 16 02 12	300	kg

16 02 14	Pajisje skarco, të tjera nga ato të përmendura në 16 02 09 deri 16 02 13	20	kg
16 03 05*	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme	400	kg
16 05 06*	Kimikate laboratorit që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme përfshirë përzjerje të kimikatëve laboratorike	20	kg
16 06 01*	Bateri plumbi	560	kg
16 06 02*	Bateri Ni-Cd	60	kg
16 06 03*	Bateritë që përmbajnë merkur	20	kg
16 06 04	Bateritë alkaline (përveç 16 06 03)	40	kg
16 06 05	Bateri dhe akumulatorë të tjerë	20	kg
16 07 08*	Mbetje që kanë naftë	1000	kg
16 07 09*	Mbetje që përmbajnë substanca të tjera të rrezikshme	20	kg
16 10 01*	Mbetje të lëngshme ujore, që kanë substanca të rrezikshme	20	kg
17 01 07	Përzjerje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikes, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06	100	kg
17 04 09*	Mbetjet metalike të kontaminuara me substanca të rrezikshme	20	kg
17 05 03*	Dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme	1000	kg
18 01 09	Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08	20	kg
20 01 01	Letër dhe karton	1200	kg
20 01 08	Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat	4000	kg
20 01 21*	Mbetje të tubave fluorishente dhe mbetje të tjera që përmbajnë merkur	100	kg
20 01 40	Metale	1000	kg
20 03 01	Mbetjet e përziera urbane	20000	kg
20 03 04	Llumra nga gropat septike	40000	kg
Other Hazardous	Mbetjet e tjera që i përkasin katalogut shqiptar të mbetjeve që mund të lindin për shkak të urgjencës ose aktiviteteve jo të parashikueshme që do të klasifikohen si mbetje të rrezikshme pas karakterizimit	1000	kg
Other Non-Hazardous	Mbetjet e tjera që i përkasin katalogut shqiptar të mbetjeve që mund të shfaqen për shkak emergjence ose aktivitete jo të parashikueshme që do të klasifikohen si mbetje jo të rrezikshme pas karakterizimit.	1000	kg
Nr.	B. Kontejnerë dhe mallra të tjera që lidhen me menaxhimin e mbetjeve	Sasia indikuese	Njesia
1	Kontenjer i mbetjeve nga 10 deri në 18 m ³	1	cope
2	Kontenjer i mbyllur nga 5 deri në 10 m ³	5	cope
3	Kontejnerë për mbetje të përgjithshme (outdoor use) (130 - 150 cm) Gjatësia x (70-90 cm) gjerësia x (110-130 cm) lartësi	10	cope
4	Kontejner për grumbullim të veçantë (përdorim i jashtëm) gjatësia (75 -90 cm) x gjerësia (60 - 75 cm) x lartësi (110 - 130 cm)	20	cope
5	Kontejnerë për bateri të përdorura (10 -12 litra)	10	cope
6	Kutia e kontejnerëve të mbetjeve të baterive (gjatësia 100 - 130 cm x gjerësi 90-120 cm x lartësi 70-90 cm)	10	cope

7	Rezervuarë për lëngje (format ne perputhje me kerkesat e AGSco)	20	cope
Nr.	C. Kontejnerë dhe mallra të tjera që lidhen me menaxhimin e mbetjeve	Sasia indikuese	Njesia
8	Kontenjer i mbyllur 1 m ³	10	cope
9	Kontejner për grumbullim të veçantë (zyra) gjatësia (30-40 cm) x gjerësia (20-30 cm) x lartësi (70-80 cm)	60	cope
10	Rezervuari për grumbullimin e lëngut të bojatisjes së çelikut me zgarë dhe mure anësore që hiqen, me gjatësi (80 - 100 cm) x gjerësi (80 - 100 cm) x lartësi (40-60 cm) për 1 fuci ose ekuivalent në aspektin e vëllimit të përgjithshëm nëse miratohet nga AGSco. Me mure të lëvizshme (lartësia 130-180 cm)	10	cope
11	Kontenjer për lëngje 30 lt (Drum)	20	cope
12	Kontenjer për lëngje 60 lt (Drum)	20	cope
13	Kontenjeri i tipit "big bag"	60	cope
14	Etikete dhe shenja sigurie për kontejnerë	200	cope
15	Koshat e mbeturinave të zyrave	100	cope
Nr.	D. Shërbime të tjera	Sasia indikuese	Njesia
16	Transporti i mbetjeve të rrezikshme	6600	km
17	Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme	52800	km
18	Largimi i ujërave të zeza, lëngjeve të tjera me kamion cisterne të përshtatshëm	10	here
19	Analiza laboratorike për karakterizimin	10	Here

Grafiku i ekzekutimit të marveshjes kuader është 24 muaj nga data e nënshkrimit të saj

Shtojca 12

TERMAT E REFERENCËS Menaxhimi i Mbetjeve

1. HYRJE

AGSco është një ofrues i shërbimit të mirëmbajtjes së Gazsjellësit, që ushtron aktivitetin në kuadrin e Tregut Shqiptar të GazitDuke pasur parasysh veçantitë e biznesit dhe shërbimeve që ofrohen nga AGSco, Shoqëria duhet të nënshkruajë një marrëveshje në bazë të legjislacionit shqiptar për menaxhimin e mbetjeve, për deponimin e mbetjeve të saj dhe mbetjet që krijohen nga aktivitetet e Klientit.

Ofertuesi që do të ketë të drejtën e nënshkrimit të Kontratës, do të jetë përgjegjës për të siguruar që Përmbajtja e këtij objekti të shërbimeve do të zbatohet nga punëtorët e tij, si dhe nga të gjithë nënkontraktuesit /nën-ofruesit që do të përfshihen në ofrimin e shërbimeve.

2. OBJEKTI I SHËRBIMEVE

2.1.KËRKESAT PËR OFRUESIN E SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT, TRANSPORTIT DHE DEPONIMIT TË MBETJEVE DHE NËNKONTRAKTUESIT E TIJ

Ofruesi do të pajiset me të gjitha licencat që kërkohen sipas legjislacionit shqiptar mbi menaxhimin, transportin dhe deponimin e mbetjeve dhe veçanërisht me liçencën III.2.B për transportin e mbetjeve.

Të gjithë nënkontraktuesit / nën-ofruesit e specializuar që ofruesi i shërbimeve të mbetjeve do të përfshijë në procesin e përgjithshëm (përfshirë riciklimin e mbetjeve dhe objektet / impiantet e deponimit), duhet të kenë në funksion të gjitha liçencat e përshtatshme për të kryer aktivitetet sipas objektit të shërbimeve.

Gjatë fazës së tenderimit, Ofruesi duhet të paraqesë:

- listën e plotë të kontratave në funksion (për largimin, transportin dhe deponimin/ riciklimin e mbetjeve, objekt i shërbimeve), për të përmbushur si duhet kërkesat e parashikuara në kontratë;
- kopje të licencave të të gjithë nënkontraktuesve / nën-ofruesve që do të përfshihen në procesin e menaxhimit të mbetjeve;

Lista mund të përditësohet herë pas here nga ofruesi, duke marrë paraprakisht miratimin nga AGSco, për të siguruar ofrimin e shërbimeve sipas kërkesave të përcaktuara në këtë specifikim teknik.

Çdo nënkontratë e përfshirë në listën e mësipërme do të ketë një kohëzgjatje të përshtatshme për të mbuluar kohëzgjatjen e marrëveshjes që do të vendoset në funksion midis AGSco dhe Ofruesit. Gjatë fazës së tenderit, do të jepet kopje e liçencave të secilit nënkontraktues / nën-ofrues, si një kërkesë e detyrueshme.

I gjithë zinxhiri i nënkontraktimit duhet të ketë në funksion një siguracion të përshtatshëm, për të mbuluar dëmet e mundshme që u ndodhin njerëzve, mjedisit dhe pronës gjatë aktiviteteve operative.

Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis objektit të shërbimeve dhe legjislacionit në fuqi, ligji do të ketë përparësi.

2.2. KËRKESAT E KONTRATËS DHE OBJEKTI I AKTIVITETEVE

Ofruesi do të jetë përgjegjës për aktivitetet e mëposhtme:

- Largimin e mbetjeve nga ambientet e AGSco dhe Klientit.
- Transportin e mbetjeve në një impiant /objekt të liçencuar për mbetjet
- Marrjen, përpunimin, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve
- Lëshimin e çertifikatave dhe shënimeve të transferimit dhe plotesimin e të gjithë dokumenteve që kërkohen me ligji dhe nga procedurat e AGSco dhe Klienti.

Aktivitetet do të kryhen sipas parimeve të përcaktuara në kapitullin "Menaxhimi i mbetjeve" të dokumentit AGSco-STD-001 "Standardet e SHSM për Kontraktuesit". Zbatimi i këtyre parimeve duhet të konsiderohet i detyrueshëm edhe për të gjithë nënkontraktuesit / nën-ofruesit e përfshirë në aktivitetet, duke përfshirë objektet / impiantet e deponimit të mbetjeve.

Aktivitetet mund të kërkohen në bazë të lajmërimeve në vendndodhjetë AGSco (Zyrat qendrore të Tiranës, Qendra e Mirëmbajtjes Korçë, Njesia Fier, Njesia Çorovodë) dhe vendpunimet e Klientit (Stacioni i kompresorit Fier, stacioni i matjes Bilisht, Stacionet e Bllok – Valvulave të tubacionit, Qendra e Mirëmbajtjes Berat).

Pervec vendndhjeve të listuara më sipër, vende të tjera mund të komunikohen me vone nëse do të jete e nevojshme. Por në çdo rast këto vendndodhje do të jene brenda gjurmës së Gazsjellesit TAP (Klientit të AGSco)

Siguruesi:

- Zbaton kërkesat e përcaktuara në Procedurën e Kontrollit të Mbetjeve të AGSco dhe Klientëve të AGSco dhe në legjislacionin kombëtar në fuqi;
- Siguron, përmes një laboratorit të akredituar, shërbimin e karakterizimit të mbetjeve, kur kërkohet nga AGSco / ligji;

- Siguron kopje të lejes ose liçencës nga autoriteti kompetent, i cili i autorizon ata të marrin, transportojnë, përpunojnë dhe azgjesojnë mbetjet, për të gjitha palët e përfshira nëpërmjet një nënkontrate;
- Siguron, përsa i përket kompetencës së tij, përgatitjen e të gjitha dokumenteve që kërkohen me ligj në lidhje me largimin, transportin dhe azgjesimin e mbetjeve;
- Siguron kopje të dokumentacionit të mbetjeve (d.m.th. shënimin e transferimit të mbetjeve), për secilën dërgesë të marrë nga AGSco dhe Klientitët e tij në kantierin e punës, që konfirmojnë marrjen e mbetjeve;
- Siguron mbetjet që merren nga kantieri i punës së AGSco dhe të Klientit të tij.
- Kur kërkohet nga AGSco, secili Transportues i Mbetjeve duhet të sigurojë prova të dokumentuara, me anë të të cilave konfirmohet se automjetet që transportojnë mbetje janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar në fuqi;
- Përgatit certifikatat e deponimit përfundimtar nga objekti i marrjes së mbetjeve tek Kontraktuesi, AGSco dhe Klienti i tij;

Ofruesi do të ketë përgjegjësinë për të siguruar që detyrimet e përmendura më lart do të përmbushen gjithashtu në të gjithë zinxhirin e Nënkontraktimit.

I gjithë procesi i lëvizjes së mbetjeve nga zonat e përkohshme të depozitimit të mbetjeve ose çfarëdo pike tjetër e grumbullimit të mbetjeve nga transportuesi i mbetjeve shoqërohet me një shënim për transferimin e mbetjeve, i cili plotësohet me Fletën e të Dhënave të Sigurisë së Materialeve (për dërgesat e mbetjeve të rrezikshme) dhe çdo dokumentacion tjetër që kërkohet sipas legjislacionit kombëtar.

Përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria e burimeve të brendshme dhe të jashtme të Kontraktuesit për menaxhimin e mbetjeve i nënshtrohet verifikimit të përputhshmërisë nga AGSco dhe Klienti i tij. Të paktën, çdo vit, departamentet e QHSE (Cilësia, Shëndeti, Siguria & Mjedisi) i të dy Kompanive mund të kryejnë kontroll në ambientet e transportuesve të mbetjeve dhe marrësve të mbetjeve të palëve të treta, në mënyrë që të verifikojnë nëse standardet e AGSco dhe të Klientit të tij janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi, duke përdorur një listë specifike të inspektimit.

Ofruesi do të ketë fleksibilitetin për të siguruar AGSco dhe Klientin e tij (sipas kërkesave të AGSco) me kontejnerë të përshtatshëm, që mund të merren me qira ose të blihen, sipas Shtojca 1.

Kontejnerët e lartpërmendur mirëmbahen nga Ofruesi dhe do tu vendoset etiketë në gjuhën angleze dhe shqipe, i cili përmban të gjithë informacionin që kërkohet sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

2.3. KATEGORITË E MBETJEVE

Ofruesi do të jetë përgjegjës për transportimin dhe transferimin në objektet e duhura të mbetjeve, të mbetjeve të kategorive të mëposhtme:

- Letër dhe karton

- Plastikë
- Metal
- Mbetjet e Përgjithshme Urbane të Drurit
- Ujë të kontaminuar (gjithashtu uji me vaj)
- Vaj i djegur
- Ujë i pijshëm
- Tonerat për printer
- Bateritë e dëmtuara dhe bateritë e harxhuara të pajisjeve;
- Ujëra të zeza
- Materiale të tjera të rrezikshme dhe jo të rrezikshme

Në Shtojcën 1 jepen informacione më të hollësishme dhe sasitë dhe klasifikimet e vlerësuara.

2.4. KARAKTERIZIMI I MBETJEVE

Kur është e nevojshme, ofruesi i shërbimit siguron, përmes laboratorëve të akredituar të analizave të një pale të tretë, karakterizimin e saktë të mbetjeve.

Pas kryerjes së analizës, laboratorit i akredituar i palës së tretë lëshon çertifikatat përkatëse, që përmbajnë të paktën:

- Referencën për AGSco ose njësinë e saj territoriale të Klientit që ka krijuar mbetjet;
- Kodin Evropian të Katalogut të Mbetjeve (EWC);
- Përshkrimin e zgjeruar të mbetjeve (që nuk kufizohet në emrin zyrtar të EWC);
- Metodën e marrjes së mostrave. Mostrat mund të mblidhen nga:
 - Personeli kompetent i ofruesit të shërbimit;
 - Personeli kompetent i laboratorit;
 - Personeli i AGSco. Në një rast të tillë, procedurat e marrjes së mostrave të shërbimeve dakordësohen me laboratorin që do të kryejë analizën dhe ofruesi i Shërbimit do të lehtësojë procesin.
- Çdo parametër të analizës, metodën e lidhur me analizën, pasigurinë lidhur me matjen dhe vlerën kufi të referencës, aty ku është e pranishme;
- Një deklaratë përfundimtare që duhet të përmbajë:
 - kodin e saktë EWC që do t'i atribuohet mbetjeve në bazë të procesit të prodhimit të treguar nga AGSco;
 - rezultatet e analizave;
 - në rastin e mbetjeve të rrezikshme, kategoritë perkatëse të rrezikut;

2.5. SHËNIMET E TRANSFERIMIT

Në fund të ciklit, Ofruesi duhet t'i dorëzojë AGSco, brenda afateve të përcaktuara me ligj, një kopje të dokumentit të kthimit të dorëzimit (dokumenti i transferimit), të siguruar nga objekti i deponimit të mbetjeve, me anë të së cilës vërtetohet dërgimi i saktë në objektet e duhura të mbetjeve që krijohen nga aktivitetet.

2.6. Planifikimi i aktiviteteve dhe marrëveshja e niveleve të shërbimeve

Në mënyrë që të mundësohet një ofrim efektiv dhe efikas i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, para fillimit të aktiviteteve, do të mbahet një Takim Kick off (KOM) ndërmjet AGSco ofruesit të shërbimeve.

Gjatë Takimit "Kick off" KOM do të diskutohet Plani HSE (Sigurise se shëndetit dhe mjedisit) dhe të gjitha procedurat përkatëse (shih kapitujt vijues). Për më tepër, gjatë të njëjtit takim, një Plan i Menaxhimit të Mbetjeve që do t'i bashkangjitet Planit HSE (Sigurise se shëndetit dhe mjedisit) do të duke vendosur:

- Kategoritë e mbetjeve që konsiderohen të prodhuara në mënyrë rutine;
- Frekuenca dhe vendet e largimit të mbetjeve rutinë;
- Distancat midis vendeve ku normalisht do të prodhohen mbeturina dhe pajisjeve për marrjen e mbeturinave që përdoren normalisht nga Ofruesi. Për të gjitha vendet dhe objektet për marrjen e mbeturinave që nuk janë identifikuar si zakonisht gjatë Takimit "Kick off" KOM, AGSco dhe ofruesi i shërbimeve do të bien dakord për sasinë e kilometrave që do të nevojiten. Këto të dhëna do të përdoren për të aplikuar tarifa sipas normave që përcaktohen në shtojcën 1 list Lista e Çmimeve '.
- Aspektet operacionale për aktivizimin e shërbimit;
- Marrëveshjet e nivelit të shërbimit për mbetjet jo-rutinë;
- Informacioni minimal që përmbahet në faturë.

2.7 SHSM (SHËNDETI, SIGURIA & MJEDISI)

Ofruesi zbaton të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar, me referencë të veçantë, por pa u kufizuar në:

- Ligjin për shëndetin, sigurinë & mjedisin;
- Zbatimin nga Shqipëria të Rregullores Ndërkombëtare ADR (Marrëveshja për transportin e mallrave të rrezikshëm me rrugë tokësore);
- Kuadrin rregullator të mbetjeve në Shqipëri

Gjithashtu, Ofruesi do të zbatojë:

- "Standardet minimale të SHSM të AGSco për kontraktuesit" që është e zbatueshme për aktivitetet e tij dhe ofrohet së bashku me këtë objekt të shërbimeve.
- Politikat e klientit të AGSco, kur aktiviteti zhvillohet në vendpunimet e Klientit.

Të gjitha procedurat përkatëse do të sigurohen pas dhënies së të drejtës për nënshkrimin e kontratës dhe në çdo rast para hyrjes në vendpunimet operative.

Përveç të gjitha veprimeve që kërkohen për zbatimin e ligjeve shqiptare në lidhje me sigurinë e shëndetit dhe mjedisin, ofruesit i kërkohet të përgatisë para fillimit të aktiviteteve, një plan specifik

të SHSM, i cili duhet të koordinohet me planin specifik të AGSco, që përmban masat në funksion për të adresuar rreziqet lidhur me shëndetin, sigurinë dhe mjedisin të lidhura me kryerjen e këtyre Shërbimeve. Përveçse sa përmendet në AGSco-STD-001, Plani i SHSM-së:

- përcakton veprimet që duhen të merren për të kontrolluar ato rreziqe në një nivel të pranueshëm, me referencë të veçantë për:
 - Shëndetin, sigurinë dhe mjedisin në punë;
 - Sigurinë e transportit rrugor;
 - Sigurinë e fazës së ngarkim / shkarkimit;
- përfshin një listë të të gjithë personelit të trajnuar dhe kompetent, të angazhuar në kryerjen e punës;
- përshkruan zbatimin e dispozitave të AGSco dhe klientëve të AGSco, në të gjithë zinxhirin e nënkontraktimit;
- përcakton organizimin dhe përgjegjësitë e QHSE-së;
- përcakton menaxhimin e aspekteve mjedisore.

Ofruesit mund t'i kërkohet të monitorojë treguesit kryesorë specifikë të performancës çdo muaj, sipas një modeli që do të jepet para fillimit të aktiviteve.

Ofruesi duhet të dorëzojë, së bashku me kopjen e listës së personelit, të gjitha certifikatat përkatëse të trajnimit, të lëshuara nga një organ / autoritet / ent kompetent dhe i licencuar, për të gjithë personelin, i cili do të përfshihet në ofrimin e shërbimeve, madje edhe në të gjithë zinxhirin e tij nënkontraktues.

2.7.1 MBETJET QË KRIJOHEN NGA AKTIVITETET E KONTRAKTOREVE DHE NËNKONTRAKTOREVE

Kontraktuesi është përgjegjësi i vetëm për të gjitha mbetjet që krijohen nga aktivitetet e tij (urbane, speciale, të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) sipas parashikimeve të ligjit shqiptar. Në veçanti, Ofruesi i Shërbimit duhet të sigurojë në mënyrë të saktë:

- Menaxhimin
- Karakterizimin dhe klasifikimin
- Transportin dhe dërgimin në një strukturë të përshtatshme të mbetjeve;

AGSco rezervon të drejtën për vete ose për Klientin që të kontrollojë që mbetjet e krijuara nga Kontraktuesi menaxhohen në përputhje me legjislacionin aktual, duke kërkuar dokumentacionin e mostrës ose duke kryer kontrole.

2.7.2 AUTOMJETET

Të gjitha dispozitat e përgjithshme të përcaktuara nga AGSco-STD-001 janë në funksion.

Kërkesa në lidhje me IVMS të dokumentit AGSco-STD-001 "Standardi minimal i SHSM për kontraktuesit" është hequr. Megjithatë, Kontraktuesi do të zbatojë dispozitat e AGSco dhe Klientit të AGSco në lidhje me politikat e sigurta të drejtimit të automjetit.

Automjetet e transportimit të mbetjeve duhet të jenë çertifikuar si duhet sipas legjislacionit shqiptar, për të transportuar mbetjet, dhe duhet të jenë:

- të përshtatshme për mbetjet që transportohen
- të pajisur si duhet për të parandaluar rrjedhjet ose derdhjet (madje edhe me kitet e përshtatshme të derdhjes)
- të mbuluara për të parandaluar përhapjen dhe humbjen e mbetjeve gjatë transportit

Të gjitha automjetet duhet të jenë të përshtatshme sipas qëllimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, në veçanti duke iu referuar:

- Kodit Rrugor Shqiptar;
- Ligjit shqiptar për zbatimin e Marrëveshjes për Transportin Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (Rregullorja ADR);
- Ligjet shqiptare për menaxhimin e mbetjeve.

2.5.1. SISTEMI I MENAXHIMIT TË QHSE-SË (CILESIA, SHENDETI, SIGURIA, MJEDISI)

Ofruesi duhet të ketë në funksion një sistem të menaxhimit të QHSE-së bazuar në:

- ISO 9001
- ISO 14001

Ofruesi duhet të sigurojë kopje të Çertifikatave të vlefshme të lidhura me fushën e shërbimeve që do të ofrohen

2.5.2. SEANCAT INFORMUESE

Para fillimit të aktiviteteve, Ofruesi do t'i mbaje seanca informuese personelit të AGSco, në lidhje me ofrimin e shërbimeve në vendet e mëposhtme (1 për secilin vend):

- Selia në Tiranë;
- Njësia Fier;
- Qendra e Mirëmbajtjes Korçë;
- Stacioni i kompresorit Fier

2.6. KËRKESAT MINIMALE TEKNIKE PËR REZERVUARIN E KONDENSIMIT

Ofruesi do të garantojë që rezervuarët e kondensimit në stacionin ACS03 dhe ACS02 duhet të zbrazen nga çisterna me anë të pompave të ngarkimit dhe me anë të një tubi fleksibël të lidhjes.

Para ngarkimit, duhet të lidhet një kabllo teli fleksibël bakri midis rezervuarëve të kondensimit dhe kamionit për të siguruar që ato janë të lidhura siç duhet në mënyrë ekuipotentiale me rrjetin tokësor të impiantit.

Ofruesi do të garantojë që sistemi i lidhjes midis rezervuarëve të kondensimit dhe kamionit të vakumit të kondensimit duhet të jetë si vijon:

- të pajiset me madhësinë e lidhjes bashkuese 2" sipas ISO 14420-7;
- të jetë i pajisur me nje rrjete kunder shkendijave ne marmite

Detajet e mëtejshme teknike në lidhje me lidhjen mund të gjenden në shtojcën e mëposhtme teknike:

- P&ID - Rezervuari i kondensimit ACS02 (Vizatimi: ACS02-C1448-381-P-DPE-0001-01);
- P&ID - Rezervuari i kondensimit ACS03 (Vizatimi: ACS03-C1448-381-P-DPE-0001-01).

Sa i përket ujërave të zeza, dy pikat që duhet të mblidhen janë në stacionin e kompresorit Fier (ACS03) në zonën e Semanit dhe në stacionin e matjes Bilisht (ACS02), afër Bilishtit. Tubi fleksibël i lidhjes duhet të jetë së paku 20 metra e gjatë dhe presioni i pompës së kokës së thithjes duhet të jetë së paku 3 bar.

Detajet e mëtejshme teknike për sa i përket lidhjes midis rezervuarëve dhe kamionit gjenden në shtojcën e mëposhtme teknike:

- ACS02-C1448.1120-510-H-DHA-0002-01_IAB_Z_20191030_EN;AL_EN; AL ;
- ACS02-C1448.1120-510-P-DPE-0001-01_Z_IAB_20191030_EN;AL_EN; AL ;
- ACS03-C1448.1120-510-H-DHA-0002-01_IAB_Z_20191030_EN;AL_EN; AL ;
- ACS03-C1448.1120-510-P-DPE-0001-01_Z_IAB_20191030_EN;AL_EN; AL .

3. TARIFAT

Ofruesi duhet të sigurojë një vlerësim ekonomik për shërbimet, sipas modelit që ndodhet bashkangjitur këtij objekti të shërbimeve ne Shtojcen I. Çmimi për njësi i vlerësimit të mbetjeve duhet të përfshijë:

- Largimin e mbetjeve nga objektet e AGSco dhe Klientit të tij (duke përfshirë fuqine punetore);
- Riciklimin, procesimin, azgjuesimin apo trajtimin sipas kategorise se mbetjes në një ambient / impiant të përshtatshëm ne perputhje me ligjin ne fuqi
- Menaxhimin e dokumentacionit;
- Seancën fillestare informuese;

Artikulli "Materiale të tjera të rrezikshme" dhe "Materiale të tjera jo të rrezikshme" të përmendura në "listën e kategorive të mbetjeve" do të tarifohet, duke marrë parasysh që:

- Vlera totale që mund të vendoset për këtë artikull nuk mund të tejkalojë 15% të vleres totale të kontratës;
- Çmimi nuk mund të jetë më i lartë se mesatarja e të gjithë çmimit të përgjithshëm që ndodhet në listën e mbetjeve.

Sasite treguese për secilën "Kategori të Mbetjeve" është sasia maksimale e një kategorie specifike të mbetjeve që mund të prodhohet në përgjithësi mbi baza vjetore nga AGSco dhe Klienti i tij. Këto sasi nuk përbëjnë asnjë angazhim për AGSco.

Të gjitha tarifat e tjera do të kuotohen sipas Shtojces 1.

Për kontejnerët, tarifat duhet të përfshijnë:

- Transportin në vendin e kërkuar
- Mirëmbajtjen e koshit të mbetjeve dhe konteniereve, kur jepet me qira;
- Etiketimin fillestar për kontejnerin e blerë;
- Ri-etiketimin (nëse kërkohet) për kontajnerët e marrë me qira;

Per transportin, cmimi i ofruar përfshin te gjitha kostot e leviszes se mjetit. Struktura e cmimeve per cdo sherbim (pervec perjashtimeve ne Shtojca 1) jane:

$$\text{Cmimi} = (W \times \text{U.P.}) + (\text{km} \times \text{U.T.P})$$

Ku:

- W = pesha ose volume qe do te trajtohet
- U.P. = cmimi I unifikuar I mbetjeve qe do te trajtohet sipas annex I
- km =KM torale qe do te pershkohen nga AGS/Vendodhja e Klientit deri tek impainti I trajtimit,procesimit Brenda teritorit Shqiptare
- U.T.P = Kosto e unifikuar e transportit sipas Shtojca 1

*Cdo export I mbetjeve jashte territorit shqiptare duhet te dakortesohert perpara nga AGSco dhe te realizohet ne perputhje me Legjislacionin shqiptare dhe nderkombetare.

4. KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e ketij sherbimi do te jete per 2 vjet (24 Muaj)

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

